



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE DHE JURIDIKE

Nr. 189 prot.

Fushë-Arrëz, më 24 . 01 . 2025

PROJEKT-VENDIM

NR. 06 , DATË 24 . 01 . 2025

**PËR DHËNIE TITULL "QYTETAR NDERI" I BASHKISË FUSHË-ARRËZ
Z. NDOC MARK PRENDI**

Në zbatim të Nenit 54, pika "m" të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar; të neni 3, pika 1; neni 14, pika 1; neni 15, pika 1/a dhe 2; neni 16, pika 1; neni 17; neni 18; neni 19; neni 20, pika "ç", të ligjit Nr. 112/2013 "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujve vendor të nderit në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; ligjit Nr.94/2022 "Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në RSH"; Të neni 113, pika "dh", të ligjit Nr.8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Kryetari i Bashkisë, si dhe Shoqata "Lëvizja Vendlindja Amanet", referuar CV dhe informacioneve të grumbulluara propozon Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz:

T'i jepet titulli "Qytetar Nderi" i Bashkisë Fushë-Arrëz, Z. Ndoc Prendi, me motivacionin:
"Për kontributin e vazhdueshëm dhe përkushtimin e tij në edukimin e brezave ndër vite si dhe mbështetjen e vazhdueshme në ndihmë të familjeve në nevojë në fshatrat e Njësisë Administrative Blerim në gjatë 15-të viteve të drejtimit me ndershmëri të kësaj Njësie".

Sektori i Burimeve Njerëzore

Fationa SELIMAJ

Juriste

Redona Hasani

Kryetar

Hil CURRI



Adresa: Rruga Qendër, Bashkia Fushë-Arrëz

email: info@bashkiafushearrez.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FUSHË-ARRËZ

SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE DHE ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Nr. 189/1 prot.

Fushë-Arrëz, më 24 . 01 . 2025

RELACION

PËR MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR TITULL "QYTETAR NDERI" I BASHKISË

FUSHË-ARRËZ TË Z. NDOC MARK PRENDI

Mbështetur në ligjin Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar; në ligjin 112/2013, "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; ligji Nr.

94/2022 "Për titujt e nderit dhe titujt vendor të nderit në RSH"; pas vlerësimit të kërkesës së bërë për dhënien e titullit qytetar nderi z. Ndoc Mark Prendi, me qëllim që të vlerësohet puna dhe kontributi i tij:

Spektori i Asistencës Ligjore dhe Burimeve njerëzore, Fushë-Arrëz, duke konsideruar propozimin e bërë u propozon anëtarëve të Këshillit të Bashkisë që të vlerësohet figura dhe personaliteti i z. Ndoc Mark Prendi, duke iu dhënë titulli i nderit në shenjë respekti dhe mirënjohje publike për të gjithë kontributin dhe punën në funksion të komunitetit:

T'i jepet titulli "Qytetar Nderi" i Bashkisë Fushë-Arrëz, z. Ndoc Mark Prendi me motivacionin: "Për kontributin e vazhdueshëm dhe përkushtimin e tij në edukimin e brezave ndër vite si dhe mbështetjen e vazhdueshme në ndihmë të familjeve në nevojë në fshatrat e Njësisë Administrative Blerim në dymbëdhjetë vite të drejtimit me ndershmëri të kësaj Njësie".

Ky titull jepet në shenjë nderimi dhe vlerësimi për gjithë kontributin dhe përkushtimin e tij në edukimin e brezave ndër vite si mësues si dhe kontributin e vazhdueshëm në ndihmë të familjeve në nevojë në fshatrat e Njësisë Administrative Blerim ku dhe ka shërbyer si Kryetar i Komunës Blerim për 15 vite me radhë në periudhën 2000-2015, duke qenë një nga kryetarët më të suksesshëm.

Z. Ndoc Prendi njihet nga banorët e trevës si njeriu i dijes, i punës dhe mbi të gjitha njeriu i thjeshtë i cili gëzon respektin e gjithë banorëve të komunitetit.

Për të gjitha meritat propozohet t'i akordohet titulli "Qytetar Nderi i Bashkisë Fushë-Arrëz".

Spektori i Burimeve Njerëzore

Fationa SELIMAJ

Juriste

Redona Hasani

Kryetar

Hil CURRI



Adresa: Rruga Qendër, Bashkia Fushë-Arrëz

email: info@bashkiafushearrez.gov.al